



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr 11504 Prot

Gjirokastërmë 17:12:2024

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së dates 12.12.2024

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së dates 12.12 .2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në 12.12.2024 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet te mediateka pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:10
Marrin pjesë në mbledhje 22 anëtarë. Mungojnë në mbledhje: Çabeli, Feruni, Aliko, Kocollari, Novi, Kondi. Rova,

Z. Qeli është online

Hapet mbledhja nga Znj. Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 05.12.2024

2. P/Vendim “Për miratimin e kriterëve për përdorimin e fondit të kushtëzuar ose fondit të buxhetit vendor, mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% (përqind), për vitin 2025”.

4. P/Vendim” Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelin e pagave në Bashkinë Gjirokastër për vitin 2025”.

5. P/Vendim “Për miratimin e PBA 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025”.

6. P/Vendim “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”.

8. Të ndryshme.

Znj Isaraj lexon dhe paraqet para këshillit 1 pikë shtesë të propozuar nga ekzekutivi. P/Vendim “ Për miratimin e fondit të veçantë me qëllim shpërblimin e punonjësve mbështetës.”

Z. Llogo: E mbështesim këtë iniciativë të bashkisë , vjen në momentin e duhur dhe i propozojmë ekzekutivit që të gjejë mundësi për rritje të pagave të këtyre punonjësve.

Z. Brahim: Të shikohet mundësia që t’i marrin sa më shpejtë, para fundit të vitit.

ZNJ. Isaraj: Nismë për t’u përshëndetur

Z. Golemi: Patjetër që I kemi mbështetur por sa për informacion në 2019 I kemi gjetur me pagë 30.000 lekë dhe sot që flasim pagat e punonjësve mbështetës janë në vlerën e 60.000 lekë bruto dhe 45.000 neto. Mundësinë e këtij shpërblimi na e realizoi performanca e mirë në mbledhjen e të ardhurave. Shpërblimi vjen për rreth 200 punonjës të shërbimeve komunale dhe manovratorët nga Drejtoria e Bujqësisë. Mendojmë që në mënyrë peridike me të ardhurat e veta bashkia të mbështesë punonjësit për vështirësinë e punës që kanë.

Miratohet me 19 vota pro rendi i ditës së mbledhjes me një pikë shtesë.

Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro procesverballi I mbledhjes së dates 02.11.2024 dhe 15.11.2024

Znj. Znj. Isaraj hedh ne votë pikën 2 dhe miratohet me 21 vota pro. Vjen në mbledhje z. Çucani dhe z. Ponde.

Znj. Isaraj; Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës.

P/Vendim "Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelin e pagave në Bashkinë Gjirokastër për vitin 2025".

Z.Llogo: Materiali ka kaluar në Komisionin e Ekonomisë . Nuk ka ndryshim në nr maksimal të punonjësve 641 si në vitin e kaluar.Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro P/Vendim" Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelin e pagave në Bashkinë Gjirokastër për vitin 2025".

Znj. Isaraj; Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës.

"Për miratimin e PBA 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025".

Z. Llogo: Komisioni e kaloi këtë pikë në mbledhjen e djeshme ne morëm në komision sqarimet e duhura nga Drejtoria e Financës.

Buxheti I përgjithshëm zë 198 milion lekë . Kemi një ulje të shpenzimeve për paga rreth 62% nga 68% që zinin vitin e kaluar dhe është rritur me 40milion lekë shpenzimet për investime.

Shpenzimet operative nga 14% në 18% në 2025.

Sqarimet e mëtejshme dhe më të detajuara i keni nga Drejtoria e Financës.

Znj. Artiste Koko bën një paraqitje në PP për buxhetin

Projekt Buxheti Afatmesëm është një buxhet afatgjatë I cili mbështetet mbi Planin e Përgjithshëm Vendor I miratuar në vitin 2017 dhe rishikohet në vitin 2033. dhe përfshin PBA 2025-2027 dhe Buxhetin Vjetor 2025.

Për buxhetin vjetor 2025 keni të pasqyruar të ardhurat dhe shpenzimet.

Shpenzimet për pagat shkojnë në vlerën e 645.914.000 lekë, shpenzimet operative në vlerën 209.740.000 dhe shpenzimet kapitale në vlerën 1756.010.000 lekë.

Janë gjithsej 8 programe buxhetore ku secili prej tyre është I ndarë në funksione të cilat janë 26 dhe çdo funksion është i ndarë në produkte.

Gjatë vitit 2025 pjesë e buxhetit bëhen edhe 6 projekte të fituara nga Bashkia Gjirokastër..

Në sljaderat më poshtë do të shikoni 8 programe dhe funksionet që mbulon secili program

Buxheti I vitit 2025 ruan balancat ndërmjet shpenzimeve kapitale, shpenzimeve për paga dhe shpenzimet operative.

Më tej sqarohen të 8 programet me funksionet përkatëse dhe produktet për çdo funksion me termat teknike dhe me shifrat përkatëse.

Janë shtuar dy drejtori , Drejtoria e Sherbimit Social dhe Arsimor dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe e Performancës.

Buxheti 2025 parashikon mbështetjen për rritjen e kapacitetit të burimeve njerëzore me fonde 50% nga Pushteti Qëndror dhe 50% nga Pushteti Vendor.

Si përfundim Buxheti nuk është vetëm si arsyetim I praktikave dhe procedurave të mirëmenaxhimit dhe përdorimit të fondeve dhe si pasqyrë e e të ardhurave dhe shpenzimeve, por është një document gjithëpërfshirësdhe ndërveprimi midis institucioneve dhe komunitetit.

Si një process pune që identifikon nevojat e komunitetit dhe I vlerëson ato.

Buxhetin e shohim si instrumentin kryesor për të bërë të pamundur për komunitetin.

Znj. Isaraj ; Faleminderit për sqarimin e detajuar znj. Koko.

Z. Golemi: Për vitin 2025 kemi 3 shtylla kryesore në zbatim të buxhetit të cilat janë ; Të ardhurat vendore, Investimet vendore dhe qëndrore dhe investimet nga projektet me financim të huaj. Është

detyrimi ynë funksional të vazhdojmë investimet e filluara me rrugën e Zhulatit, Shkollën “Muhamet Gjollesha”, investimet për emergjencat, jo në momentin që ndodhin por për parandalimin e tyre kemi parashikuar rreth 400.000 milion lekë në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile. Kemi parashikuar një mjet zjarrfikës për zonën muzeale, investimi të tregu fshatar për të patur një treg me standard në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Bujqësisë.

Ndërhyrje në terrenet sportive në zbatim të marrëveshjes së miratuar nga ju në mbledhjen e kaluar me FSHF. Terrenet në parkun e Viroi duan investim sepse janë degraduar dhe duhet ndërhyrje në kuadër të projektit “Dua të luaj” Ndërhyrje në kanalet vaditëse.

Gjithashtu do të vazhdohet me ndërhyrjet në shkolla ku përfitues kemi 2 shkolla “Çajupi” dhe “Urani Rumbo”. Ndërhyrje dhe mbështetje për Shërbimet Sociale për të cilat jemi në komunikim të vazhdueshëm me Entin Kombëtar të Banesave për ndërtimin e banesave sociale.

Në bashkëpunim me FSHZH do të investohet në vlerën e 3 milion eorove për rrugët ku janë përfshirë riasfaltimi I rrugës nga fshati Arshi Lengo deri te parku I Antigonesë dhe rruga Kolonjë-Golem me mbështetjen edhe të donatëve me një fond rreth 180 milion lekë , riasfaltimi rrugës Votuca Kolonjë për më vonë, rehabilitimi I 8 fasadave te hyrja e lagjes “ Punëtori”. Zëri I fundit në buxhetin e vitit 2025 janë projektet IPA dhe Interreg me një fond rreth 750.000 euro dhe do të jetë edhe më I lartë sepse kemi projekte që kemi aplikuar. Duhet të yhem se ky buxhet është I shpërndarë dhe prek me investime të gjitha njësitet administrative duke e parë qytetin dhe njësitet administrative si një mozaik të plotë.

Z. Petrit Brahim: Kjo është një rezyme e qartë dhe një project ambicioz . Sygjeroh që investimi I parashikuar në segmentin Ura e Lumit , Arshi Lengo. Antigone nuk është emergjente, por rruga te tregu rom është në një amortizim total, rruga “ Baba Selim” është shumë e vështirë për tu kaluar dhe paraqet probleme për banorët. Ju thoni se investimet I bën FSHZH, por a punojnë ata në bashkëpunim me ju, ju duhet të marrin mendimin tuaj. Nga Palortoj ate Qarku nuk është emergjente.. Duhet të planifikoni 2 pasarella për fushat e fshatit Lazarat, nuk kanë sit ë kalojnë. Emergjencia e përroit të Sopotit.

A ekziston mundësia për të ndryshuar disa nga destinacionet e investimeve?

Z. Golemi: Këta janë zëra të ndarë

Gjithashtu ne çojmë projekte, kemi aplikuar me kërkesë për 30 fasada dhe kemi përfutuar 8 faszda . Ndërhyrjet në Zonën Historike janë grante të Bankës Botërore dhe nuk ua ndryshon dot destinacionin, plus që janë të domosdoshme dhe nuk mund të bëjmë kaq shumë vetëm me fondet e bashkisë. Rruga e Zhulatit po bëhet me fobdet e bashkisë , sepse projektet e fituara na kanë dhenë mundësi. Ne aplikojmë për disa ndërhyrje , por projektet nuk përzgjidhen nga ne. Unë kam kërkuar edhe rrugë të reja. Por rruga “Baba Selim” nuk bëhet me beton, do ndërhyrje të plotë, me kanalizime, me shtrat , por duhet me standard. Ne aplikojmë për çdo thirrje, por nuk I zgjedhim ne fituesit.

Z. Guçe: Rruga e Antigonesë përmblytet , nuk ka trung për filtrimin e ujërve. Gjatë sezonit turistik nuk u jep mundësinë mjeteve si autobusat të kalojnë. Verën që shkoi e mbyllëm me 3000 turistë , do të ketë edhe më shumë se rruga I afron.

Z. Golemi: Me Bankën Botërore po punojmë për një treg fshatarësh dhe një market bio për produktet e fshatit. Gjithashtu investimi në Virua për urën e re najep mundësinë e një hapësire publike që mund ta kthejmë në pedonale.

Z. Erion Kore: Në Zenelaj janë të interesuar për rrugën e cila duhej të mbaronte.

Z. Golemi: Është duke punuar dhe besoj mbaron shumë shpejt.

z. Arianit Muho: Te Viroi nuk pashë investime për ujësjellës. Të mendohet diçka për liqenin e Viroit për ujin gjatë gjithë vitit sepse është pikë e rëndësishme e qytetit.

Për Shtëpinë e të moshuarve nuk ka ndonjë investim të ri për zgjerim të kapaciteteve. Për protestën e punonjësve u ra dakord me bonusin?

Z. Golemi: Ne nuk kemi nevojë të biem dakord sepse I kemi gjetur me rrogë 250 dhe I kemi çuar në 450. I kemi mbështetur çdo vit dhe do vazhdojmë ti mbështesim. Viroi është investim I madh , nuk bëhet me fondet e bashkisë. Ne investuam me kondicioner për Shtëpinë e të Moshuarve. Është objekti në Libohovë por duhet parë.

Znj. Anila Ccaj: Jemi mbledhur vitin e kaluar për emergjencat dhe kemi kaluar ndërhyrjen për te rruga "Tahir Kadare". Nuk është bërë ende ndërhyrja.

Z. Golemi Është ndërhyrë për murin. Igjithë fondi ka qenë 15 milion të vjetërta. Nënkryetarja që merret me rrugët ta shikojë dhe të merren masa. Është për tu falënderuar për turizmin dhe qendrat kulturore dhe muzeumet që janë bërë të vizitueshme , por nuk është e njëjta ndjeshmëri për qytetarët që jetojnë këtu në këtë qytet . Kjo bashkia jonë vetëm me FSHZH punon, nuk ka një strukturë. Lidhja e rrugës "Baba Selim" me fshatin Lazarat mund të çojë edhe aty njerëz.

Z. Petrit Brahim: Rruga "Baba Selim" nuk është në Lazarat.

Z. Golemi: Rrugë me fonde 100% të bashkisë kemi disa rrugë. Turizmi është në funksion të qytetarëve sepse sjell të ardhura për qytetarët.

Hidhet në votë dhe miratohet me 22 vota pro P/Vendim "Për miratimin e PBA 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025".

Hidhet në votë dhe miratohet me 22 vota pro pika 6. P/Vendim "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026"

Miratohet me 22 vota pro pika shtesë:

P/Vendim "Për miratimin e fondit të veçantë me qëllim shpërblimin e punonjësve mbështetës."

Mbyllet mbledhja nga znj. Isaraj në orën 13:20

Sekretar i Këshillit

Etleva YZO



KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ

